



Prishtinë: 24 qershor 2008
Kodi i ZRRE-së: D_093_2008
Nr.i Referencës ERO/CPD_D_68_01_07

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e dhëna Zyrës së Rregullatorit për Energji në Nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat e Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe proceset e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK në ZRRE: ZRRE/DMK_V_68_01_07 të datës 15 janar 2008;
5. Parashtrimin e kundërshtimit të vendimit të DMK-s nga ana e konsumatorit, drejtuar Bordit të ZRRE-së, me datë 06 mars 2008;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i konsumatorit z. Salih Llumica (shifra e konsumatorit në KEK: DPR – 70476) nga Besiana, kundër Vendimit të DMK për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

1. Konsumatori në ZRRE ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A të datës 21 nëntor 2006 me numër të referencës DPR – CO1 lidhur me faturimin pa matje.
2. Me datë 14 qershor 2006 KEK Sh.A ka bërë Procesin nr. 7 mbi heqjen dhe ndërrimin e numëruesit për bazhdarim, ku me anë të këtij procesi është hequr njehsori i vjetër me nr. 21061730 me gjendje T1=07502 kWh dhe T2=00002 kWh i prodhimit SIEMENS dhe është vënë njehsori i ri me numër 39958057 me gjendje T1=00007/00310 kWh me T2=00006/00682 kWh i prodhimit ISKRA.
3. Me datë 12 korrik 2006, pas kërkesës nga konsumatori ekipi i autorizuar i KEK Sh.A del në vendin e ngjarjes dhe sipas procesverbalit nr. 008394 konstaton se konsumatori posedon njehsor elektrik të tipit Siemens - 20304 me nr. 21061730, dhe me gjendje T1=07502 kWh dhe T2=00002 kWh dhe me numër të vulës (bllombës) distributive 046906. Gjithnjë sipas të njëjtit procesverbal konsumatorit i është ndërruar njehsori dhe i është vendosur njehsori i tipit ISKRA trefazor-dytarifor me nr. 39958057 me gjendje T1=00384 kWh dhe T2=00861 dhe me vulë (bllombë) numër 10084288.
4. Konsumatori me datë 21 nëntor 2006 ka bërë ankesë ndaj KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë lidhur me faturimin pa matje – paushall të ngarkuar nga KEK Sh.A.
5. KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë në përgjigjen e dhënë konsumatorit shpjegon se deri në muajin 06/2004 konsumatori është faturuar me njehsor,



6. Ndërsa prej 06/2004 është fatruar paushall sepse nuk ka pasur njehsor elektrik. Poashtu në përgjigje theksohet se konsumatori e ka vendos njehsorin në muajin 07/2006 dhe nga ajo datë faturohet sipas gjendjes. Në vazhdim të përgjigjes KEK-u shpjegon se me datën 16 tetor 2006 në kartelën e konsumatorit i është korrigjuar shuma prej 276.00€.
7. Me datë 14 maj 2007 konsumatori në ankesën e tij nr. 66/05 2007, i është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke apeluar përgjigjen e KEK Sh.A të datës 21 nëntor 2006 ku kërkon që t'i fshihet borxhi paushall dhe të faturohet sipas gjendjes.
8. Me datë 15 janar 2008 DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KEK Sh.A ka vendosur që pjesërisht të pranoj ankesën e konsumatorit për periudhën 02/2006 – 06/2006, ndërsa ta refuzoj për periudhën 04/2004 – 2006.
9. Me datë 06 mars 2008 konsumatori ka parashtruar kundërshtimin e tij kundër vendimit të DMK të ZRRE-së në Bordin e ZRRE-së.

Andaj për arsyet e paraqitura më lart, Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta refuzoj konsumatorin si në arsyetimin e paraqitur në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Nysret Avdiu, Anëtar